



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 30.07.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.07.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "AFA-ING" për aktivitetin: "Furnizimi dhe montimi I kamerave ne institucionet arsimore" me Nr. të Prok: 616 19 064 121 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "AFA-ING" e datës 28.07.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi I kamerave ne institucionet arsimore" me Nr. të Prok: 616 19 064 121 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të datës 23.07.2019 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 23.07.2019 .

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "AFA-ING" me datë 28.07.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe montimi I kamerave ne institucionet arsimore" me Nr. të Prok: 616 19 064 121 .

Autoriteti Kontraktues, me datë 30.07.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Çdo rivlerësim nënkupton vlerësim të ri dhe në asnjë rrethanë nuk do të thotë se komisioni i rivlerësimit duhet të beje vlerësime të njëjt si komisioni paraprak .

Për këtë arsyeje komisioni i rivlerësimit ka vlerësua ne detaj të gjitha ofertat dhe ka konstatuar se produkti qe e keni ofruar për pozicioni 2 nuk i përmbush specifikat teknike te kërkuara ne Aneksin 1 për këtë arsyeje kërkesa juaj për rishqyrtim refuzohet

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës ,
- Departamentit të prokurimit; dhe
- Njësisë së kërkesës.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit